



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PERGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE**

RELACION TEKNIK



“MIREMBAJTJE E THELLE E OBJEKTEVE PUBLIKE (AMK)”

- 2022 -

TE DHENA TE PERGJITHSHME

Objekti AMK

Vendodhja: Agjensia e Mbrojtjes se Konsumatorit ndodhet ne Njesine Administrative Nr.2, ne Rr. Murat Toptani ne nje godine tre kateshe, ku zyrat e AMK ndodhen ne katin e dyte me siperfaqe te pergjithshme prej 540 m2.



Vleresimi fizik I objektit:

Grupi I punes pas verifikimit, matjeve te gjendjes faktike ne objektin AMK evidentoi disa problematika specifike, te cilat lidhen kryesisht me sallen e madhe dhe kuoten e pllakave te dyshemese. Salla e madhe eshte e ndare ne zyra , ku secila prej tyre eshte e ndare me mur gipsi dhe vetrate me dyer d/alumini deri ne nje lartesi prej 2 m, e cila lejon depertimin e zhurmave nga nje zyre ne nje tjetere.

Objekti I studimi – projektimit do te jete:

“ Mirembajtje e Thelle e objekteve Publike (AMK)” per ti krijuar ambienteve te gjitha parametrat optimal per zhvillimin normal te procesit te punes, duke respektuar kriteret teknike te projektimit dhe standartet ne fuqi.

Kushtet konstruktive dhe funksionale per objektin:

“ Mirembajtje e Thelle e objekteve Publike (AMK)”

VETRATA

Punimet do te fillojne me heqjen e vetratave dhe dyerve d/alumini, duke vazhduar me prishjen e punimeve elektrike, si dhe prishjen e murit ndares te gipsit tek salla e madhe.



PLLAKAT

Me pas do te vazhdohet me heqjen e pllakave tek zyrat te cilat jane ne disnivel si dhe transportimi i mbetjeve nga objekti.

Punimet do te procedojne me pas me punimet e shtresave te betonit per te arritur kuoten e nivelit te dyshemese se korridoreve. Mbi shtresen e betonit do te hidhet nje shtrese lluster cemento dhe me pas do te kemi dhe vendosjen e pllakave te shtrimit si dhe plintuesit perreth zyrave. Nderrimi i pllakave rekomandohet dhe per arsye estetike, ne menyre qe te jene te njetrajtshme dhe me te njejten ngjyre, pasi ky factor ndikon ne anen vizuale tek personat prezente.



TAVAN DHE MUR GIPSI

Tek zona e salles se madhe do te kemi ndertimin e murit te gipsit qe do te arrije deri ne nivelin e tavanit, ku do te kemi dhe krijimin e tavanit kartonxhes. Muri i gipsit tek salla do te ndertohet me dopio pllake gipsi dhe me lesh guri ne brendesi.

Tek cdo zyre do te vendoset dore druri per te zevendesuar dyert e d/aluminit qe jane hequr.

Zyrrat do te kene nje ndricim te plote sipas ndarjeve qe ato kane, duke u plotesuar dhe me priza dhe celesa.



RECEPSIONI

Zyra e informacionit (sporteli) do te kete prishje te murit ekzistues dhe do te rekomandohet krijimi I nje banaku deri ne nje nivel prej 1-1.5 m I ndare ne pjesen e siperme me nje xham te temperuar deri ne tavan. Dera hyrese tek sporteli do te jete dere xhami.

Objekti do te lyhet me boje dhe aty ku ka nevojte do te kete dhe stukime apo patinime te pjeseve te demtuara.

